




Republika e Kosovës
Zyra e Auditorit të Përgjithshëm

Nr. 01.1-2009-02

Strategjia për Zhvillim të Përbashkët



Përmbajtja

1. Hyrje
2. Përqëndrimi ynë strategjik
3. Vizioni, Misioni dhe Vlerat
4. Hisedarët dhe partnerët
5. Objektivi Strategjik
6. Qasja strategjike
7. Treguesit dhe Masat e Performancës
8. Resurset

Shtojca 1 Plani i veprimit

1 HYRJE

Kjo Strategji për Zhvillim të Përbashkët është e bazuar në Planin paraprak Strategjik Zhvillimor 2006 - 2012 i nxjerrë nga ish-Auditori Përgjithshëm më 24 gusht 2006. Objektivi i kësaj strategjie është që të caktohet rruga dhe udhëzuesi në krijimin e Zyrës Kombëtare të Auditimit në Kosovë deri në fund të vitit 2013, një institucion i qëndrueshëm i udhëhequr nga vetë Kosovarët në kryerjen e punës në pajtim me standardet e auditimit të pranuar ndërkombëtarisht dhe me praktikat e mira evropiane.

Auditori Përgjithshëm është përgjegjës për implementimin e strategjisë gjatë mandatit të tij 5 vjeçar. Në planin shoqëruar ofron hollësi në lidhje me detyrat, afatet kohore, treguesit e progresit dhe palët përgjegjëse. Për çdo vit do të shqyrtohet progresi i arritur në zbatimin e planit dhe do të bëhen përshtatjet e nevojshme në mënyrë që të sigurohen rezultatet e planifikuara dhe të shtrohet rruga për ndikimin e tyre.

Zyra e Auditorit është themeluar në vitin 2003 nën patronatin e administratës së atëhershme të përkohshme të Organizatës së Kombeve të Bashkuara në Kosovë. Objektivi ynë është të sigurohet lidhja e llogaridhënies ndërmjet Kuvendit, Qeverisë dhe menaxhmentit të shpenzuesve të buxhetit. Zyra do të punojë në arritjen e këtij objekti duke ndërmarrë auditime të pavarura të pasqyrave financiare dhe administratës financiare të subjekteve të sektorit publik dhe raportimit të rezultateve të të audituarit, kuvendi dhe opinioni i gjerë.

Që nga fillimi, Zyra ka qenë përfitues i një vargu të vazhdueshëm të projekteve zhvillimore, duke përdorur ekspertë ndërkombëtarë për zhvillimin dhe plotësimin e kapacitetit të saj për përmbushjen e objektivave organizative. Fillimi i mandatit të Auditorit të ri të Përgjithshëm ka qenë edhe rast për shqyrtimin e objektivave dhe progresit të Zyrës së Auditimit drejt atyre objektivave, të mësohet nga përvojat e fituara dhe për rivënien e strategjisë për 5 vitet e ardhshme.

2 VIZIONI, MISIONI DHE VLERAT

Gjatë ofrimit të auditimit të jashtëm për sektorin publik ne kemi shfrytëzuar Vizionin, Misionin dhe Vlerat e dhëna më poshtë:

Misioni i ynë

Misioni ynë është:

“të kontribuojmë për menaxhim të mirë financiar në administratë publike. Ne do të kryejmë auditime të kualitetit në harmoni me standardet e auditimit të njohura ndërkombëtarisht dhe me praktikat e mira evropiane. Ne do të krijojmë besueshmëri në shpenzimin e fondeve publike. Me këtë ne synojmë të luajmë rol aktiv për të siguruar interesin e tatimpaguesve dhe palëve tjera për rritjen e llogaridhënies publike”.

Kjo është në harmoni me mandatin e shprehur në Ligjin tonë dhe është i rëndësishëm së posaçme në kontekst të rolit tonë në projektin e ndërtimit të shtetit të Kosovës.

Vizioni i ynë

Vizioni ynë me theks të veçantë për Periudhën e Planifikimit Strategjik (5 vite) është ndërtimi i një Zyre të qëndrueshme Kombëtare të Auditimit në Kosovë, si Institucion Suprem i Auditimit dhe udhëhequr në tërësi nga Kosovarët dhe me tipare si më poshtë:

- Profesionist të shkathët dhe të angazhuar në një kulturë pozitive e orientuar në të mësuar;
- marrëdhënie të ngushta të punës me palët e interesuara, dhe me partnerët vendor dhe ndërkombëtar;
- pjesëmarrja në komunitetin ndërkombëtar të ISA-ve; dhe
- ofrimi i sigurisë së besuar për qytetarët e Kosovës dhe përfaqësuesit e tyre të zgjedhur në lidhje me shfrytëzimin ligjor, të drejtë, ekonomik, efektiv dhe të matur të resurseve publike.

Vlerat tona

Vlerat tona janë bazë e metodave të funksionimit. Ato duhet të ofrojnë bazë të fortë etike për çfarëdo veprimi ose vendimi të marrë në emër të Auditorit të Përgjithshëm dhe të jenë udhëzues në momentet e pasigurisë.

Vlerat tona duhet t'i kemi parasysh gjatë punës tonë të përditshme. Këto vlera na japin identitet dhe na mundësojnë të punojmë së bashku për arritjen e synimeve të përbashkëta. Vënia e vlerave në praktikë do të ndihmojë në kryerjen e detyrave në mënyrë efikase, efektive dhe konsistente.

Vlerat për reputacion të jashtëm

Kompetenca

Zyra e jonë do të jetë organizatë e bazuar në dituri. Për të mbajtur reputacion të mirë, për të siguruar kredibilitet dhe për të ruajtur integritetin tonë, ne varem nga punonjësit me kompetencë të lartë që gjenden në të gjitha pjesët e organizatës.

Ekselenca profesionale

Vazhdimisht duhet të ofrojmë punë me kualitet të mjaftueshëm dhe të përdorim standardet dhe praktikatat profesionale të zbatueshme. Ne duhet të inkurajojmë dhe të shpërblejmë risitë dhe orvatjet për përmirësime të vazhdueshme në ekonominë, efikasitetin dhe efektivitetin e punës tonë.

Pavarësia

Pavarësia ka rëndësi vendimtare për të siguruar integritetin dhe kredibilitetin e kërkuar dhe për të krijuar besimin e shoqërisë ndaj punës tonë.

Objektiviteti

Të gjitha komunikimet me shkrim dhe verbale do t'i prezantojmë në mënyrë neutrale, të drejtë, konstruktive dhe të baraspeshuar. Ne do të orvatemi të arrijmë saktësi dhe besueshmëri. Ne do të sigurojmë që auditorët të mbajnë qëndrim të pavarur.

Vlerat për bashkëpunim të brendshëm

Si në rastin e aspekteve të jashtme të punës sonë, ne gjithashtu duhet të sigurojmë që ekipet tona punojnë në aso mënyre e cila krijojnë shpirt të bashkëpunimit. Këtu synohet që të krijohet një organizatë ku efektiviteti i Zyrës tonë në tërësi maksimizohet duke krijuar strukturë organizative dhe një grup të punonjësve që me aftësitë e tyre plotësojnë njëri-tjetrin dhe ku njihet dhe zhvillohet potenciali i secilit punonjës në atë mënyrë që rrit kapacitetet dhe kredibilitetin e Zyrës tonë. Sa i përket kësaj duhet të krijohen vlerat si më poshtë:

Shpirti ekipor

Ne do të arrijmë rezultatet më të mira kur veprojmë dhe bashkëpunojmë si ekip. Kontribuimi i kompetencës tonë unike promovon ndarjen e njohurive dhe rritjen e kompetencës.

Çiltërsia

Komunikimi i hapur dhe eksplicit rezulton me konfidencë dhe kënaqësi në punë. Nivel i lartë i tolerancës së karakteristikave, shkathtësive dhe përvojave individuale ofron hapësirë për zhvillim të përgjithshëm.

Respekti

Të gjithë punonjësit tanë do të ndihen të çmuar. Kjo krijon konfidencë dhe besim, të cilat janë parakushte për të punuar me kapacitetin më të mirë të një personi.

Vlerësimi i individëve

Ne punësojmë njerëz të talentuar. Ne duhet të njohim të arriturat e tyre dhe të zbatojmë sisteme të drejta dhe fleksibile për t'i ndihmuar të gjithëve në arritjen e potencialit të plotë të tyre. Ne vlerësojmë dallimet ndërmjet individëve dhe diversitetin që sjelljet nga ata në organizatë.

3 PËRQËNDRIMI YNË STRATEGJIK

Kjo Strategji e Zhvillimit të Përbashkët përqendrohet në zhvillim të suksesshëm të Zyrës tonë në një Institucion të vërtetë Suprem të Auditimit i cili përmbush rolin dhe mandatin e tij në pajtim me standardet e auditimit të njohura ndërkombëtarisht dhe me praktikatat e mira evropiane. Këto përbëjnë elementet kyçe për krijimin e qeverisjes dhe administratës së mirë të financave publike në Kosovë.

Qëllimi ynë është kontribuimi i dukshëm në zhvillimin e Republikës së Kosovës. Fokusi ynë është si më poshtë:

1. Auditimet tona do të jenë të kualitetit të duhur dhe të sigurojnë llogaridhënie dhe integritet në menaxhimin e financave dhe performancën e administratës publike. Në mënyrë të drejtpërdrejtë kontribuojmë në ambiciet e Kuvendit dhe Qeverisë për implementim të deleguar dhe më efektiv të buxhetit, duke prodhuar një bazë solide për të mbajtur shpenzuesit e buxhetit llogaridhënës për mënyrën e ekzekutimit të buxhetit.
2. Komisioni për Buxhet dhe Financa në Kuvend është përgjegjës për kontrollimin dhe mbikëqyrjen e shpenzimeve publike. Ky është një rol i rëndësishëm. Ne do të përpiqemi të përmirësojmë afatet kohore, lejueshmërinë dhe relevancën e raportimit tonë, si dhe të zhvillojmë marrëdhëniet me këtë komision dhe me Qeverinë në kohën kur niveli dhe kompleksiteti i aktiviteteve qeveritare bëhet më kompleks.
3. Ekonomia është prioritet për Kosovën, si dhe kemi një proces të privatizimit dhe ristrukturimit të ndërmarrjeve shtetërore që është duke u bërë. Ne do të orvatemi të zhvillojmë mbikëqyrjen e këtyre proceseve.
4. Përforcimi i sundimit të ligjit dhe promovimi i ekonomisë formale është i rëndësishëm thelbësor. Duhet të dekurajohen praktikatat e korrupsionit dhe kanaleve joformale. Bazuar në rolin dhe mandatin tonë do të marrim qëndrim proaktiv në luftën kundër mashtrimeve dhe korrupsionit që dëmtojnë ekonominë dhe pengojnë zhvillimin e Kosovës në të ardhmen.
5. Ne do të kontribuojmë në elementin "Qeverisja e Mirë" të procesit përcjellës të Stabilizim-Asociimit ku janë të përfshira kriteret për hyrje në BE.
6. Ne do t'i shtojmë vlerë palëve tona dhe do të kryejmë auditime me kosto efektive të fokusuar drejt fushave materiale me rreziqe të rëndësishme.

3.1 Auditimi i Jashtëm i Sektorit Publik

Parimet e përgjithshme që qeverisin auditimin e jashtëm të sektorit publik janë themeluar në Deklaratën e Limas për Udhëzuesit mbi Normat e Auditimit, të muajit tetor 1977, në INCOSAI-në e IX-të të mbajtur në Lima (Peru) me qëllim të shtytjes së zhvillimit të auditimit të pavarur qeveritar nga Institucionet Supreme të Auditimit në të gjitha vendet e botës. I njëjti udhëzim është rinxjerrë nga INTOSAI në vitin 1998 pa ndonjë ndryshim, për të demonstruar se ende është dokument valid.

Deklarata e Limas është e bazuar në pranimin e përgjithshëm që:

- shfrytëzimi si duhet dhe efikas i fondeve publike është i rëndësishëm thelbësor për të trajtuar financat publike dhe efektivitetin e vendimeve të sektorit publike;
- për arritjen e shfrytëzimit të duhur dhe efikas të fondeve publike nevojitet ekzistimi i Institucionit Suprem të Auditimit në secilin vend, ku pavarësia e institucionit të tillë është e garantuar me ligj;
- objektivat specifike të auditimit që kryesisht janë shfrytëzim i duhur dhe efektiv i fondeve publike; zhvillimi i menaxhimit të mirë financiar; ekzekutimi i duhur i aktiviteteve administrative; komunikimi i informatave të autoritetit publike dhe opinionit të gjerë përmes publikimit të raporteve objektive, janë të nevojshme për stabilitetin dhe zhvillimin e shteteve në mbajtjen e synimeve të Kombeve të Bashkuara.

Auditimi i jashtëm i sektorit publik është një pjesë e pandarë e sistemit rregullativ i cili synon që:

- të zbulojë devijimet nga standardet e pranuar dhe shkeljet e parimeve të ligjshmërisë, efikasitetit, efektivitetit dhe ekonomisë së menaxhimit financiare, në fazën e hershme që mundëson ndërmarrjen e veprimeve korigjuese në rastet individuale;
- llogaridhënësit të marrin përgjegjësi;
- të sigurohet kompensim ose të ndërmerren hapa për parandalimin e devijimit të tyre ose të zbuten devijimet më të mëdha.

3.2 Auditimi i Jashtëm i Sektorit Publik në Kosovë

Zyra jonë fillimisht është krijuar me Rregulloren e UNMIK-ut 2002/18 dhe ka filluar aktivitetet në vitin 2004. Sipas këtij aranzhimi, Auditori Përgjithshëm ishte ekspert ndërkombëtar i cili ka funksionuar i pavarur nga PSSP-ja mirëpo i ka raportuar atij. Financimi kryesor për ndërtimin e institucionit është ofruar përmes Shtyllës IV të UNMIK-ut dhe Agjencisë Evropiane për Rindërtim, ku BKK-ja ka mbuluar kostot operative përfshirë këtu pagat dhe kontraktimin e auditorëve.

Ne që nga fillimi kemi pranuar përkrahje të konsiderueshme për ndërtimin e kapaciteteve dhe aktivitetet tona i kemi zgjeruar për të përfshirë auditime të rregullsisë dhe të performancës nëpër ministri, komuna dhe ndërmarrje shtetërore, si dhe auditimin e pasqyrave financiare të BKK-së. Ne jemi anëtarë të EURORAI që nga muaji tetor 2004 përmes së cilit kemi pasur qasje në rrjetin e organizatave simotër në regjion.

Kohëve të fundit ka pasur zhvillime të rëndësishme të cilat kanë ndikuar tek ne pas Shpalljes së Pavarësisë së Kosovës dhe krijimit të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Kuvendi në qershor të vitit 2008 ka miratuar Ligjin e ri për Themelimin e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm në Kosovë dhe Zyrën e Auditimit në Kosovë (**Ligji nr. 03/L-075**) për promovimin e standardeve të larta të transparencës, llogaridhënies dhe integritetit në menaxhim financiar dhe performancë të administratës publike.

Sipas Ligjit të ri, Auditori Përgjithshëm emërohet, raporton dhe është përgjegjës para Kuvendit. Për pjesën që nuk financohet nga burimet tjera, Zyra e Auditimit duhet të financohet nga BKK-ja. Nga Kuvendi kërkohet që të sigurojë alokim të fondeve të mjaftueshme nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës për Zyrën e Auditimit për t'i mundësuar përmbushjen e funksioneve dhe përgjegjësi siç parashihet dhe në mënyrë të pavarur.

Në të njëjtën kohë, në Propozimin Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës është rënë dakord që Auditori Përgjithshëm i Republikës së Kosovës të jetë ndërkombëtarë deri në përfundim të periudhës së mbikëqyrjes ndërkombëtare të implementimit të propozimit. Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar në janar të vitit 2009 ka emëruar një ekspert ndërkombëtar si Auditor Përgjithshëm për një mandat 5 vjeçar dhe i cili i nënshtrohet vetëm ligjit dhe Kuvendit. Këto ngjarje kanë hapur një kapitull të ri në zhvillimin e Zyrës së Auditimit dhe ofrojnë kontekstin për azhurnimin e strategjisë zhvillimore të organizatës.

3.3 Fushëveprimi i Auditimit të Jashtëm të Sektorit Publik

Auditori i Jashtëm ka një fushëveprim të gjerë për ushtrimin e kompetencave të Zyrës. Kompetencat dhe përgjegjësitë tona përcaktohen me Kushtetutë dhe ligj, dhe nga to rrjedh fushëveprimi i auditimit të sektorit publik në Kosovë. Fushëveprimi i përgjithshëm mund të përmblihet si më poshtë:

1. *Auditimet e Rregullsisë* të Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës, organizatave buxhetore, përfshirë por duke mos u kufizuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës, Zyrës së Presidentit të Republikës së Kosovës, secila Ministri dhe agjenci ekzekutive, komunat, organet e pavarura, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQRK) dhe subjektet tjera me pronësi publike më të madhe se 50% ose që pranojnë financim, apo japin dividenda ose të hyra tjera jo-tatimore për, Fondin e Konsoliduar të Kosovës, përfshirë këtu, por duke mos u kufizuar në, Shërbimin Doganor të Kosovës, Agjencinë Kosovare të Privatizimit dhe Ombuds-personit; dhe

2. *Auditimet Diskrecionare të Performancës* të çfarëdo institucioni ose subjekti të përmendur më lartë.
3. Llojet tjera të Auditimit brenda mandatit, sipas zgjedhjes së Auditorit të Përgjithshëm.

4 HISEDARËT DHE PARTNERËT

Ne nuk ekzistojmë për përfitime tona, e as nuk mund të përmbushim funksionet në mënyrë efektive pa pjesëmarrjen e partnerëve të shumtë. Një numër i palëve të jashtme kontribuojnë ose përfitojnë nga arritjet e misionit, vizionit dhe objektivave tona. Pasi që në nivele të ndryshme suksesi i jonë varet nga veprimet e palëve të tilla atëherë strategjia jonë përfshinë angazhimin me secilin prej tyre.

Qytetarët si përfitues përfundimtar të aktiviteteve të qeverisë, duhet të sigurohen se financat publike përdoren në mënyrë efektive dhe efektive për ofrimin e programeve sociale dhe përfitimeve publike.

Kuvendi përbëhet nga përfaqësuesit e zgjedhur të njerëzve të Kosovës dhe është hisedari kryesor institucional në punën tonë. Ekzistimi i një Zyre të fuqishme të Auditimit do t'i sigurojë që Ministrinë dhe shpenzuesit buxhetor, të cilëve Kuvendi i ndanë para dhe delegon përgjegjësi ekzekutive, përmbushin mandatet e tyre në mënyrë efektive dhe efektive duke i dhënë konsideratë të duhur obligimeve ligjore, ndershmërisë financiare dhe integritetit.

Komisioni Buxhetor dhe i Financave në Kuvend është pikë kontakti ndërmjet Kuvendit dhe Auditorit të Përgjithshëm. Objektivat tona janë:

- Diskutimi i çështjeve buxhetore dhe financiare;
- Diskutimi i buxhetit vjetor të Republikës së Kosovës;
- Caktimi i shpenzimeve që mund të alokohen nga secili projektligj dhe dhënia e rekomandimeve për komisionet funksionale të Kuvendit, në rastet kur një gjë e tillë është e përshtatshme;
- Mbikëqyrja parlamentare e ekzekutimit të Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës;
- Paraqitja e raporteve në Kuvend për debatimin e rezultateve dhe konkludimeve.

Aktualisht është duke u marrë parasysh krijimi i Komisionit për Llogaritë Publike. Komisioni i tillë zgjeron marrëdhënien punuese të parlamentit me zyrën tonë dhe promovon mbikëqyrjen e aktiviteteve qeveritare nga ana e tyre. Nëse ose kur të krijohet KLIP-ja, ky komisioni në përkrahjen e Zyrës tonë mund të kryej këto funksione:

- Shqyrtimi (por jo i drejtpërdrejtë) i aktiviteteve tona;
- Të sigurojë që Zyra jonë t'i nënshtrohet auditimit të pavarur të jashtëm;
- Të na udhëzojë në llojet, formatin dhe përmbajtjen e raporteve tona për Qeverinë, me qëllim të rritjes së efektivitetit të tyre;
- Komunikimi i çështjeve prioritare të Kuvendit;
- Të sigurojë që raporteve tona u kushtohet vëmendja e duhur nga Kuvendi për të mundësuar që Qeveria të mbahet llogaridhënëse;
- Të sigurojë ekspozim dhe hetim adekuat të çështjeve të auditimit;
- Të inicioj reagime ndaj raporteve tonë, futjen në shfrytëzim të asistencës teknike nga ne aty ku është e nevojshme.

Në përmbushjen e këtyre funksioneve, Komisioni për Llogaritë Publike dhe Zyra e Auditimit do të kenë rolin e përkrahjes reciproke në sigurimin e qeverisjes efektive. Kuvendi mund të kryej në mënyrë më efektive funksionet e tij mbikëqyrëse kur shfrytëzon dhe kur mund të mbështetet në punën e auditimit të Zyrës së Auditimit. Ngjashëm, Zyra e Auditimit mund të jetë shumë më efektive kur Kuvendi dhe komisionet e tij ofrojnë tribunë për prezantimin dhe diskutimin e rezultateve të rëndësishme të auditimit dhe janë aleat i mundshëm në inkurajimin e fuqishëm të të tjerëve për ndërmarrjen e veprimeve përkatëse korrigjuese.

Qeveria si subjekt përgjegjës për ekzekutimin e BKK-së, është homologu ynë kryesor. Është thelbësore që të kemi marrëdhënie të shkëlqyeshme me Qeverinë. Veçanërisht, Ministria e Ekonomisë dhe Financave por edhe Ministria e Administratës Publike, si Ministri kyçe për zhvillim

dhe implementim të sistemeve, strukturave dhe praktikave në kuadër të fushës së Menaxhimit të Shpenzimeve Publike.

Stafi i jonë si resursi më i vlefshëm, është hisedari kryesor i cili përfiton nga lidhja me një punëdhënës i cili mund të ofrojë:

- Trajnime dhe testime profesionale
- Mjedis pozitiv mësimor i cili krijon kulturë profesionale
- Mundësi për zhvillim të karrierës
- Qasje në rrjet ndërkombëtar
- Përkrahje dhe asistencë profesionale për auditorët, për t'i ndihmuar në kryerjen e punës në pajtim me standardet relevante dhe praktikat më të mira
- Mundësi për Zhvillim të Vazhdueshëm Profesional.

Ne gjithashtu mbështetemi në bashkëpunimin e *subjekteve të sektorit publik* që i nënshtrohen auditimit, në si më poshtë:

- ofrimin e informatave të kërkuara;
- dhënien e dëshmive të Auditorit Përgjithshëm ose një zyrtari të autorizuar;
- prodhimin e dokumenteve që kanë të bëjnë me ushtrimin e detyrave të tyre;
- lejimin e qasjes së plotë në prona ose dokumente.

Si kthim, kemi obligim që pas përfundimit të secilit auditim t'i raportojmë subjektit të audituar dhe përgjigjet e tyre t'i bashkëngjisim në raport të auditimit.

Relacionet pozitive me organet e audituara janë të dobishme për të gjithë të interesuarit. Ne kontribuojmë duke demonstruar vlera pozitive të shërbimeve të auditimit që i ofrojmë dhe duke minimizuar çrregullimet e punës së auditimit përmes koordinimit të aktiviteteve të auditimit me Njësitë e Auditimit të Brendshëm.

Në kuadër të subjekteve, marrëdhënia me Zyrtarët Kryesor Administrativ (ZKA) është e rëndësishme, pasi që personat e tillë kanë autoritet kryesor të përditshëm për operacionet, personelin, financat dhe për prodhimin e pasqyrave financiare dhe raporteve të aktiviteve: llogaridhënës së bashku me Ministrin (aty ku një gjë e tillë është e zbatueshme).

Mediat mund të luajnë rol të madh në informimin e publikut për procesin e auditimit, Zyrën e Auditimit dhe rolin e saj, të gjeturat dhe rekomandimet e auditimit dhe veprimet përmirësuese të marra nga qeveria.

Shoqatat profesionale të auditimit përfshirë INTOSAI, kolegët që punojnë në firmat private të auditimit, shoqatat e auditimit, dhe ofruesit e ndryshëm kombëtar dhe ndërkombëtar që kanë të bëjnë me trajnimet në lidhje me auditimin gjithashtu janë të rëndësishëm për zhvillimin e përgjithshëm të profesionit tonë dhe përforcimit të transparencës dhe llogaridhënies.

Ekzistenca e Zyrës profesionale të Auditimit i jep *donatorëve* besim më të madh që asistencë financiare dhe materiale që i jepet Qeverisë përdoret në mënyrë efikase dhe efektive, si dhe për qëllime të caktuara.

Gjyqësori dhe posaçërisht prokurorët dhe institucionet që luftojnë mashtrimet dhe korrupsionin, duhet gjithashtu të konsiderohen si hisedarë të rëndësishëm.

5 OBJEKTIVAT STRATEGJIKE

Siç është thënë më herët, Strategjia për Zhvillim të Përbashkët përqendrohet në vazhdimin e zhvillimit të Zyrës tonë për të përmbushur mandatin për auditim të jashtëm siç definohet në INTOSAI dhe në Ligjin e vitit 2008 për Themelimin e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm në Kosovë dhe Zyrës së Auditimit të Kosovës.

Një ISA mund të konsiderohet se përmbush mirë mandatin nëse e plotëson një numër të karakteristikave kyçe. Këto karakteristika (të grupuara në katër grupe kryesore) janë si më poshtë:

CILËSIA E OPERACIONEVE

- Përmbushja e mandatit dhe fushëveprimit të auditimit në një mënyrë të baraspeshuar, stabile dhe afatgjate në lidhje me: auditimin vjetor të Ekzekutimit të BKK-së dhe Pasqyrave të Konsoliduara Financiare, auditimet financiare dhe të harmonisë së subjekteve individuale, auditimet e ekonomisë, efikasitetit dhe efektivitetit të performancës.
- Përmbushja e rolit si *shtyllë e rëndësishme e sistemit të llogaridhënies* në demokraci moderne - një vetëdije të lartë konceptuale për rolin dhe detyrat. Roli i një verifikuesi të pavarur të informatave ekonomike dhe të performancës si dhe të statusit nga këndvështrimi i legalitetit dhe 3 E-jave (ekonomia, efikasiteti dhe efektiviteti) në zingjirin komandues: agjenci-ministri-Qeveri dhe Parlament.
- Ndjekja e standardeve vendore dhe ndërkombëtare të auditimit, përfshirë këtu:
 - Raportimi të hisedarët përkatës në lidhje me çështjet materiale të cilat kanë ndikim.
 - Dorëzimi me kohë i shërbimeve/raporteve të auditimit të kualitetit të lartë – shtimi i vlerës së hisedarëve.
 - Procedurat përcjelljese të zhvilluara mirë për ndërmarrjeve e veprimeve nga palët në fjalë - të audituarit, Qeveria dhe Parlamenti, në lidhje me të gjeturat dhe rekomandimet e auditimit.
- Shfrytëzimi i qasjes moderne të quajtur Menaxhim i Cilësisë Totale (TQM) për Menaxhimin e Cilësisë së Auditimeve – dhe tri shtyllat e saj – Kontrolli i Cilësisë, Sigurimi i Cilësisë dhe Menaxhimi Institucional.
- Një organizatë me shikim përpara- vazhdimisht duke mësuar nga zhvillimet e jashtme si dhe nga përvojat e brendshme.
- Profesionalizmi i stafit të auditimit dhe stafit përkrahës, i demonstruar me njohuritë teknike, qëndrimet dhe sjelljet e tyre.
- Një organizatë në rritje me performancë të lartë që ofron mjedis përkrahës dhe sfidues për tërë stafin.
- Operacione efikase dhe efektive, që sigurojnë që resurset organizohen dhe futen në funksion për të optimizuar arritjen e objektivave të Zyrës së Auditimit.

MENAXHIMI I MARRËDHËNIEVE

- Marrëdhënie të mira pune me Parlamentin dhe Qeverinë – Ministrinë e Financave, mediat dhe publikun.

- Perceptuar nga hisedarët si *burim i pavarur, objektiv dhe i besueshëm i informatave*.

SINKRONIZIMI ME PARTNERË

- *Veprimi në baraspeshë me akterët tjerë në Sistemin e Menaxhimit të Financave Publike - optimizimi i përfitimeve të tërë-sistemit të Menaxhimit të Financave Publike duke marrë në konsideratë pozitën e veçantë në sistemin për Menaxhimin e Financave Publike -- ISA dhe marrëdhënia e punës me Ministrinë e Financave, Auditimin e Brendshëm të Ekzekutivit, organet profesionale, firmat e auditimit.*
- *Marrja e përgjegjësisë për pjesën e saj të zhvillimit profesional në nivel ndërkombëtar dhe kombëtar duke kontribuar në rrjetin e ISA-ve.*
- *Përfitimi nga ekspozimi ndërkombëtar përmes rrjetit të ISA-ve (përfshirë këtu posaçërisht INTOSAI dhe EUROSAI).*

KOMUNIKIMI

- *Promovimi i standardeve të larta të transparencës, llogaridhënies dhe integritetit në menaxhimin e financave dhe performancën e administratës publike.*

PARANDALIMI I MASHTRIMEVE DHE KORRUPCIONIT

- *Marrja e një qëndrimi proaktiv në luftën kundër Mashtrimeve, Parregullsive dhe Korrupsionit.*

Këto karakteristika janë synuese dhe janë një cak të cilin Zyra e jonë duhet të arrijë. Se bashku ofrojnë një model që përqendrohet në çështjet kryesore për zhvillimin e ISA-së, paraqesin kriteret për standardizim dhe për udhëzimin e studimeve diagnostifikuese, shqyrtimet nga kolegët, planet e ardhshme strategjike zhvillimore dhe aranzhimet në formë të binjakëzimeve. Këto karakteristika gjithashtu ofrojnë bazë për zhvillimin e masave përkatëse të performancës me të cilat mund të vlerësohet performanca e Zyrës tonë (shih më poshtë).

6 QASJA STRATEGJIKE

Duke pasur parasysh gjendjen aktuale të pjekurisë së Zyrës tonë, nuk është reale të pritet adresimi i plotë e secilit dimension gjatë kësaj periudhe të planifikuar. Gjithashtu pritet që me kalimin e kohës të evoluojë pikësynimi.

Synimi ynë është të kalojmë nga operacionet të kualitetit themelor të auditimit në produkte të matshme të përmirësuara të auditimit dhe për të rritur ndikimin tonë në mënyrë që të përmirësohet dhe të njihet vlera e Zyrës dhe punës tonë.

Përmirësimi i performancës mund të bëhet duke punuar në platformat jo-komplete të veglave, proceseve dhe kapaciteteve të tanishme me synim të kalimit në një Zyrë më të pjekur të Auditimit të personi i ardhshëm i Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm.

Zhvillimi platformave përgjatë horizontit të planifikuar në kuptim afatshkurtër është i lidhur me platformën fillestare "themelore" e cila pritët të vendoset në gusht 2009 dhe duke pasur si objektiv që deri në fund të periudhës së planifikimit të kemi platformë solide për t'iu bartur Auditorit të Përgjithshëm në fund të mandatit aktual. Për të kaluar nga njëra platformë në tjetrën, ne do të përdorim një qasje fazore për implementimin e platformave gjithnjë më të fuqishme gjatë periudhës së planifikuar.

Prioritetet për Përmirësim Operative

Faktorët kryesor që ndikojnë në kapacitetin e Zyrës tonë për tu bërë një ISA me performanca të mira janë faktorët e brendshëm që kryesisht kanë të bëjnë me karakteristikat e grupuara në titullin "Kualiteti i Operacioneve" të përshkruar më lartë.

Duke u përqendruar në operacionet tona të brendshme, mund të bëhet shtyrja e çështjeve tjera të rëndësishme e më pak urgjente. Rreziku i qenësishëm në situatën aktuale është që nuk ka shumë çështjet që mund të preken nga përpjekjet tona dhe posaçërisht resurset e limituara dhe Projekteve të Binjakëzimit që do të shpërndahen në aspekte të ngushta dhe do të rrezikohet progresi domethënës në çështjet kyçe.

Kjo do të thotë se prioritetet për periudhën aktuale të planifikimit (verë 2009 deri shkurt 2014) duhet të jenë krijimi i kushteve interne të nevojshme për përmirësimin e kësaj kategorie të gjerë. Këto kushte mund të përshkruhen si "Platforma", ku secila përfaqëson një varg kapacitetsh që duhet të ekzistojnë në pika të ndryshme kohore për gjatë periudhës së planifikuar. Secila platformë duhet të përkrahë përmirësimet e matshme të performancës të cilat mund të gjurmohen duke përdorur indikator të thjeshtë operacional. Lidhja e nevojshme ndërmjet platformave me kapacitet në rritje dhe arritjes së përmirësimeve të matshme në kuantitetin dhe kualitetin e rezultateve të auditimit (p.sh.. operacionalizimi i platformave) është ndryshimi i sjelljes në të gjitha nivelet e Zyrës, e që mund të karakterizohet si "profesionalizëm". Ndryshimi i sjelljeve është më i vështirë se sa zhvillimi i platformave dhe kjo do të jetë çështja më sfiduese me të cilën do të përballemi gjatë kësaj periudhe.

Gjatë kohës së përgatitjes së këtij Plani është duke u punuar në krijimin e elementeve themelore të platformës operacionale (posaçërisht Kornizës së Cilësisë, Strukturës së Auditimit, Doracakut të Auditimit Rregullativ, Udhëzuesit e Auditimit të Performancës, Kodi i Mirësjelljes dhe proceset për Raportin Vjetor të Auditimit dhe Raportin Vjetor të Performancës). Këto vegla me përjashtim të Strukturës Organizative, përqendrohen në kryerjen e auditimeve.

Kërkesat tona për resurse janë të diskutuara më tej në Kapitullin 7. Sidoqoftë, një input i njohur është projekti dyvjeçar i binjakëzimit i përkrahur nga BE-ja i cili është planifikuar të fillojë në shtator 2009. Ky projekt paraqet mundësinë për (a) përmirësimin e kapacitetit tonë duke operacionalizuar veglat në platformën bazë dhe (b) për të zhvilluar tutje veglat për zgjerimin e platformës operacionale, kësaj here duke u përqendruar në përmirësimin e kapaciteti të funksioneve të stafit

(p.sh. TIK-u, financa dhe administratë, menaxhimi i burimeve njerëzore, udhëheqje dhe planifikim strategjik të auditimit). Kjo nënkupton që puna e projektit të binjakëzimit drejtohet përtej kufijve të dorëzimit të produkteve teknike (siç janë manualët) drejt një përqendrimit të fuqishëm në implementimin e veglave dhe proceseve në mënyrë që të jenë plotësisht në përdorim.

Nevoja urgjente për adresimin e çështjeve të brendshme dhe resurset në dispozicion nga binjakëzimi për arritjen e tyre tregojnë që këto duhet të jenë prioritet për vitin 2010 dhe 2011. Zhvillimi dhe implementimi i vazhdueshëm i platformës do të shtyhet nga performanca jonë dhe kapaciteti i resurseve të brendshme (me mundësi të plotësisht nga asistencë shtesë teknike) gjatë pjesës së mbetur të periudhës së planifikimit.

Gjithashtu ekzistojnë një numër i çështjeve të jashtme që duhet t'i adresojmë. Këto mund të bëhen paralelisht me çështjet e brendshme, mirëpo duhet të konsiderohen si prioritet i ulët pasi që ndikimi i tyre do të jetë minimal në rast se bëhet përmirësimi i operacioneve thelbësore. Si rrjedhim, aktivitetet përkatëse mund të shpërndahen gjatë tërë periudhës së planifikimit, për përfundim sipas progresit të pikave prioritare dhe sipas mundësive tona.

Më poshtë është paraqitur një afat kohor preliminar për implementimin e përmirësimeve operacionale.

	Gusht 2009	Gusht 2010	Gusht 2011	Gusht 2012	Gusht 2013	Mars 2014
REZULTATET E PIKËSYNUARA						
Auditimet e performancës të përfunduara, diskutuara nga Kuvendi, me mbulim nga media, në faqe zyrtare të AAR-së dhe AO-së	2	2	3	5	8	
Auditimi i rregullsisë: Qeveria ministritë/agjencitë/komunat	23	30	40	50	60	
Auditime të rregullsisë: Ndërmarrjet shtetërore	1	3	4	6	8	
Auditime Sistematike	1	2	3	3	3	
Auditime të drejtpërdrejta të BKK-së		1	1	1	1	
Auditime të rregullsisë me fushëveprim të kufizuar		20	30	40	40	

Masat e performancës operative

Është me rëndësi kritike gjurmimi i progresit tonë drejtë arritjes së një niveli të caktuar të performancës. Ekziston një numër i dimensioneve të performancës të cilat duhet të ndërlidhen me kritere të matshme:

- **Mbulimi i auditimit** në kontekst të mandatit ligjor të Auditorit të Përgjithshëm dhe rreziqeve relative të lidhura me subjektet e ndryshme të auditimit dhe konsistente me Planin Strategjik të Auditimit.
- **Zhvillimi i kapacitetit të auditimit**, për përmbushjen e standardeve të praktikave të dhëna në Doracakun për Auditimin e Rregullsisë, Udhëzuesin për Auditim të Performancës dhe Kornizës së Cilësisë, dhe
- Ndikimi, që reflekton vlerat që hisedarët i nxjerrin nga raportet e Auditorit të Përgjithshëm.

Pikësynimet e matshme të Progresit duke përdorur kriteret e dakorduara të performancës, duhet të caktohen për secilin vit të periudhës së planifikimit dhe të matet performanca kundrejt pikësynimeve të tilla dhe raportimi në Raportin Vjetor të Performancës së Auditorit të Përgjithshëm.

Në kapitullin në vijim janë të prezantuara kriteret strategjike të performancës.

7 TREGUESIT DHE MASAT E PERFORMANCËS

Performancën tonë duhet ta monitorojmë kundrejt objektivave strategjike, duke lidhur dorëzimet tona – raportet për Kuvendin, opinionet, rekomandimet dhe këshillat e auditimit - me misionin tonë. Për një gjë të tillë duhet të caktojmë disa masa të performancës organizative dhe indikatorët kyç të ndikimit me qëllim të që informojmë menaxhmentin për vendimet e tyre.

Masat e performancës organizative do të na mundësonin të bëjmë monitorimin se deri në cilën masë:

- Arrihet cilësia e operacioneve, në kuptim të mbulimit të auditimit, kontributit në llogaridhënie dhe zbatimin e standardeve në kuadër të kornizës së cilësisë;
- menaxhohen marrëdhëniet me hisedarët;
- bëhet sinkronizimi i aktiviteteve me partnerë;
- bëhet komunikimi; dhe
- ofrohet vend i kënaqshëm i punës.

Veç kësaj, indikatorët e ndikimit do të mundësonin të bëhet vlerësimi se deri në çfarë mase:

- puna jonë ofron vlerë për shfrytëzuesit kyç të rezultateve;
- puna jonë ofron vlerë për organizatat të cilat i auditojmë;
- përdoruesit kyç të rezultateve tona janë të angazhuar në procesin e auditimit;
- përdoruesit kyç të raporteve tona dhe organizatat që i auditojmë reagojnë ndaj të të gjeturave; dhe
- qëndrimet për luftimin e mashtrimeve, parregullsive dhe sjelljeve korruptive rezultojnë me veprim.

Masat dhe indikatorët e dizajnuar mirë mund të përdoren për të vendosur kornizën e diskutimeve të prezantuara në Raportin Vjetor të Performancës së Auditorit të Përgjithshëm. Veç kësaj, duke inkorporuar konceptet e matjes të përdorura në PEFA dhe vlerësimin e OECD/Sigma, mund të ofrohen mjete për demonstrimin e kontributit tonë në synimet kombëtare për zhvillimin e qeverisjes publike.

Përfundimisht, së bashku me menaxhimin e performancës dhe ndikimit të vazhdueshëm të Zyrës, ne gjithashtu kemi objektivin prioritar zhvillimor për krijimin e një platforme të qëndrueshme të proceseve, veglave, trajnimit, organizatës dhe shkathtësive të cilat do të ndihmonin në përmbushjen e mandatit tonë përtej mandatit të Auditorit aktual të Përgjithshëm ndërkombëtar. Ky objektivi zhvillimor i nënshtrohet Planit të Hollësishtëm të Veprimit i cili shoqëron Strategjinë e Përgjithshme Zhvillimore. Plani i Veprimit përfshin hollësisht objektivat e progresit dhe kjo në një mënyrë na mundëson mbikëqyrjen e progresit kundrejt arritjes së këtij objektivi.

Masat e Propozuara të Shtrirjes dhe treguesve të Ndikimit të Veprimeve tona janë prezentuar në pjesët vijuese.

MASAT E SHTRIRJES

- përqindja e buxhetit të BKK-së e përfshirë në ekzaminim të auditimit
- përqindja apo numri i ndryshëm i institucioneve të audituara (viti/para 3 viteve)
- numri i auditimeve të kryera të performancës (viti/para 3 viteve)

MASAT E CILËSISË

- rishikimet e përafërta e konstatojnë Kornizën e CilësisëQualitetit të percaktuar në mënyrë të përshtatshme

- vlerësimet e brendshme dhe të jashtme konstatojnë se Korniza e Cilësisë është duke u alokuar në mënyrë efektive
- përqindja e rishikimeve të praktikave të brendshme e cila konstaton që auditimet tona janë në përputhshmëri me doracakët e auditimit, udhëzimeve të praktikës dhe Kornizës së Cilësisë.
- përqindja e punonjësve që janë të kënaqur me Zyrën e Auditimit si një punëdhënës
- përqindja e punonjësve në lidhje me disponueshmërinë e fuqisë punëtore që përfaqësojnë grupet minoritaredhe kategorite gjinore

TREGUESIT E NDIKIMIT

Puna jonë ofron vlera për përdoruesit kryesorë të raporteve tona

- Përqindja e anëtarëve të komisionit parlamentar të cilët konstatojnë se raportet tona janë të dobishme.

Puna jonë ofron vlera për organizatat të cilat ne i auditojme

- Numri apo përqindja e ZKA-ve të cilët konstatojnë se raportet tona janë të dobishme dhe na llogaritin si një partner të çmueshëm.

Përdoruesit kryesor të raporteve tona janë të përfshirë në proces të auditimit

- Numri i dëgjimeve dhe informimeve në të cilat kemi marrë pjesë;
- Përqindja e adutimeve të performancës rishikuar nga komisionet e themeluara të Kuvendit.

Përdoruesit kryesor të raporteve tona dhe organizatave të cilat i auditojme i përgjigjen gjetjeve tona

- Numri apo përqindja rekomandimeve të auditimit të performancës plotësisht të implementuara tri vite pas publikimit të tyre;
- Numri apo përqindja rekomandimeve të cilat janë adresuar nga nje auditim i rregullësisë deri te tjetri.

Qëndrimi ynë në luftën kundër Mashtrimit, Parregullësive dhe Aktiviteteve Korruptive na drejton te veprimi:

- Asnjë shkelje të brendshme të Kodit tonë të Mirësjelljes;
- Rrjeti për kundër korrupsion shpreh kënaqësi për bashkëpunimin tonë.

Treguesit e mësipërme të suksesit janë për të demonstruar se sa mirë janë arritur objektivat e strategjisë. Plani i detajuar i Veprimit përfshinë Objektivat e Progresit për të përcjellë progresin e aktiviteteve të projektit

8 BURIMET

Objektivat tona strategjike janë të nevojshme në rast se ne do të përmbushim rolin tonë në zinxhirin e llogaridhënies kombëtare. Për shkak të platformës modeste që aktualisht ekziston, shkalla e zhvillimit për tu arritur është domosdoshmërisht ambicioze. Në gjatë këtij viti kemi përjetuar një rënie të konsiderueshme faktike në burimet tona tashmë të kufizuara, në kuptim të themelimit, buxhetit, dhe kontributeve të donatorëve ndërkombëtarë, në mënyrë që aftësia jonë për të përmbush plotësisht mandatin tonë të veprimtarisë (auditimit) është shtrënguar. Ky nivel i burimeve është i pamjaftueshëm për të akomoduar punën zhvillimore e cila duhet të bëhet urgjentisht. Pjesët vijuese e adresojnë këtë çështje, duke pasur parasysh burimet kryesore përmes të cilave ne do të ushtrojmë objektivat tona.

Burimet Njerëzore

Tabela e mëposhtme tregon numrin e tanishëm kundrejt planit të themelimit gjatë periudhës planifikuese. Kjo e sqaron madhësinë, dhe mungesën e zhvillimit. Ne do të duhet të përfshihemi në një kampanjë të qëndrueshme rekrutimi që të arrijme zhvillimin e planifikuar pas lejimit të zvogëlimeve të pritura (përafërsisht 10-12%).

KATEGORIA	2008 AKTUAL	2009 PIKËSY NIMI	2010 PIKËSY NIMI	2011 PIKËSY NIMI	2012 PIKËSY NIMI	2013 PIKËSY NIMI
Auditor i Përgjithshëm	1	1	1	1	1	1
Personeli thelbësor	58	77	85	94	103	105
Personeli mbështetës	22	22	23	23	23	23
Totali	80	99	108	117	126	128

Përveç kësaj në sasi të Burimeve Njerëzore, ekziston edhe një shqetësim i konsiderueshëm. Ky shqetësim është mungesa e kontrollit dhe fleksibilitetit që Auditori i Përgjithshëm duhet ta ketë në përcaktimin se si të organizojë, klasifikojë dhe kompensojë personelin e tij, dhe kjo si pasojë e përfshirjes së Ministrisë së Administratës Publike duke na imponuar klasifikimet e shërbimit civil dhe praktikave të MBNJ-së, të cilat nuk janë të përshtatshme për auditimin e jashtëm publik. Siç u tha më lart, kjo e shkel fuqinë e caktuar të Auditorit të Përgjithshëm në organizimin e veprimtarive pa asnjë pengesë. Kjo situatë duhet shpejt të rregullohet, për dy arsye asaj ligjore dhe praktikave urgjente.

Burimet Financiare (në Euro)

	2008	2009	2009 rishikuar	2010	2011	2012
Buxheti i përgjithshëm	1,204,239	1,106,963	1,195,964	1,532,968	1,667,216	1,845,151
Pagat dhe medijtjet	359,696	523,230	612,231	897,735	1,025,214	1,181,649
Mallrat dhe shërbimet	812,043	551,233	551,233	598,733	599,500	616,000
Komunalitë	32,500	32,500	32,500	38,500	42,500	47,500

Buxheti i cili është në shfytëzim i vitit 2008 ka rezultuar në zvogëlim të buxhetit tonë për vitin 2009. Kjo do të ketë efekt në kufizimin e shtrirjes së auditimit që mund të arrihet, pasi që zvogëlimi i buxhetit do të ndikojë në një numër të madh të auditimeve të cilat gjatë periudhës mund të

kontraktohen. Si pasojë e kësaj personeli ynë do të duhet të përqendrohet në punën e auditimit që të mbulojë zvogëlimin e shërbimeve të jashtme dhe kjo do të kufizojë aftësinë e tyre për t'u angazhuar në punët e domosdoshme të zhvillimit të kapaciteteve.

Andaj, për këtë arsye është e rëndësishme që të merren hapa për të rivendosur reduktimin e buxhetit gjatë rishqyrtimit të gjysmë-vitit. Ne do të duhet të jemi të përgatitur për të zbatuar çfarëdo shtese të buxhetit shumë shpejt.

Njëjtë sikur me rastin me Burimet Njerëzore, nuk është problematike vetëm vlera e burimeve financiare, por edhe detyrimi nga udhëheqësit qeveritar të buxhetit. Për të mundësuar Auditorin e Përgjithshëm të organizojë veprimtarinë e Zyrës pa pengesa, buxheti duhet të jepet si shumë e caktuar (në të njëjtën mënyrë sikur mbështetje të programit), duke mundësuar Auditorit të Përgjithshëm të ushtrojë fleksibilitetin e tij të mandatuar me ligj në zbatimin e burimeve financiare siç kërkohet, se sa ta diktojë atë Ministri i Financave.

Donatorët

Viti 2009 e përcolli kompletimin e projektit i cili ishte financuar nga BE-ja në Zhvillimin e Mëtuqjeshëm të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm. Ky projekt gjatë periudhës së realizimit të tij ka dhënë burime afërsisht për 4 persona në vit. Projekti i Binjakëzimit do të fillojë menjëherë pasi që të përfundojë projekti në zhvillim. Megjithatë, projekti i Binjakëzimit do të sigurojë afërsisht vetëm gjysmën e atyre burimeve të atij numri të ekspertëve.

Si pasojë e kësaj, është urgjencë edhe më e madhe për ngritjen e zhvillimit tonë duke kompensuar për këtë mbështetje të reduktuar

Auditori i Përgjithshëm

Viti 2009 e sheh një fillim 5 vjeçar të zyrës për të cilin edhe pritet të jetë edhe mandati i fundit i një Auditori të Përgjithshëm ndërkombëtar.

Për shkak të hendekut në mes të shkathtësive të nevojshme dhe aftësive të pranishme teknike e menaxheriale të stafit të Zyrës për Auditim, dhe reduktimit shumë domethënës të ekspertizës ndërkombëtare dhënë nga donatorët, Auditori i Përgjithshëm medoemos duhet të pranojë një ndihmë më të madhe në rolin e drejtuesit për të përcjellur shkathtësitë e nevojshme teknike e profesionale gjatë qëndrimit të tij dhe të bëjë më shumë se që bëri paraardhësi i tij. Përveç kësaj ai do të ketë nevojë të zgjerojë përpjekjet që i zbaton në rolin e tij si Kryeshef ekzekutiv i cili është përgjegjës për gjithë veprimtarinë e Zyrës së Auditimit, në mënyrë që të përmbush objektivat strategjike dhe të demonstrojë vlerat e Zyrës së Auditimit për popullin e Kosovës.

Në të njëjtën kohë do të rritet në mënyrë substanciale ngarkesa në punë e Auditorit të Përgjithshëm për t'i adresuar këto trysni reale, mbështetja buxhetore ndërkombëtare për një Zëvendës Auditor të Përgjithshëm është hequr, kjo në të njëjtën duke zvogëluar ekspertizën ndërkombëtare dhe fuqinë e mundshme punëtore.

Kjo shton urgjencë të mëtuqjeshme në nevojën për rekrutim siç është cekur më lart.

PLANI I VEPRIMIT

PËR KRIJIMIN E PLATFORMËS SË ARDHSHME

Strategjia jonë bazohet në vendosjen e një platforme të qëndrueshme e cila do të mundësojë që vazhdimisht të arrijmë qëllimet tona dhe themelojmë vetën si një ILA Shumë-Funksionale.

Në përgjithësi, ne për momentin jemi në fazat fillestare të implementimit të platformës së nevojshme. Veprimet që do të ndërmerren gjatë periudhës për të vazhduar krijimin e platformës janë sikur vijojnë. Veprimet janë të përshkruara në kuptim të objektivave që duhet arritur, veprimet që duhet të ndërmerren, treguesit që do të mundësojnë progresin të mbikqyret, dhe kush do ta ketë këtë përgjegjësi.

1. Kualiteti i Veprimeve

1.1 Raportimi Vjetor i Auditimit

Objektivi

Për të përmbush obligimet ligjore të Auditorit të Përgjithshëm në prodhimin me kohë të një Raporti Vjetor të Auditimit i cili është i përshtatshëm dhe me vlerë i Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës (BKK) për Kuvendin.

Çfarë do të bëjmë

1. Ne do të zhvillojmë një pako të hollësishme të procedurave të Raportit Vjetor të Auditimit që duhet ndjekur (me gjykimin e duhur profesional dhe rregullimeve të vazhdueshme për të përmbushur nevojat evoluese) në prodhimin e Raportit Vjetor të Auditimit dhe që është i koordinuar me planin e auditimit dhe procesin e raportimit
2. Ne do të funksionalizojmë procesin e RVA-së, që do të thotë se do të jepen këshilla në mënyrë që synimi dhe realizimi i procesit është kuptuar nga anëtarët Kosovar të grupit menaxhues të Zyrës së Auditimit tek të cilët do të delegohet i tërë procesi dhe realizimi i vazhdueshëm i punëve.

REZULTATI

Një proces i strukturuar në mënyrë efektive i RVA-së që koordinon planin për raportin e Auditorit të Përgjithshëm me procesin e planifikimit dhe veprimit të Auditimit.

Treguesit e Performancës

RVA-ja është:

- Lehtë i lexueshëm, i përshtatshëm, i bazuar në rrezik dhe shton vlera në marrjen e vendimeve;
- I prodhuar dhe i paraqitur në kohë;
- Përmbush të priturat e Auditorit të Përgjithshëm mbi kualitetin e përmbajtjes dhe prezantimit.

Përgjegjësia i delegohet:

Mbështetja do të sigurohet nga:

1.2 Raportimi Vjetor i Performancës

Objektivi

Të forcojë përgjegjshmërinë e Auditorit të Përgjithshëm, në shfrytëzim të duhur të burimeve për të arritur synimet e miratuara dhe të kontribuojë në bisedat rreth buxhetit me Kuvendin

Çfarë do të bëjmë

1. Ne do të zhvillojmë një pako të hollësishme të procedurave të cilat mund të ndiqen (me një gjykim të përshtatshëm profesional) në prodhim të dobishëm të një Raporti Vjetor të Performancës (RVP) mbi veprimtarinë e Zyrës së Auditimit të Kosovës.
2. Ne do të funksionalizojmë procesin e RVP-së, fillimisht përmes këshillëdhënies për të siguruar që synimi dhe realizimi i procesit është kuptuar nga anëtarët Kosovar të udhëheqësve të Zyrës së Auditimit (momentalisht Zëvendës Auditori i Përgjithshëm), tek i cili do të delegohet procesi dhe realizimi i vazhdueshëm i punës

REZULTATI

Një proces i strukturuar në mënyrë efektive i RVP-së që vendos diskutimin e performancës me Komisionin për Buxhet dhe Financa.

Treguesit e Performancës

RVP-ja:

- Prodhuar dhe e paraqitur në kohë;
- Nxjerr diskutim të hollësishëm në mes të Zyrës së Auditimit dhe Komisionit për Buxhet dhe Financa;
- Është e integruar me Planin Strategjik të Zhvillimit dhe procesit buxhetor të Zyrës së Auditimit
- Përbush të priturat e Auditorit të Përgjithshëm mbi kualitetin e përbajtjes dhe prezantimit.

Përgjegjësia i delegohet:

Mbështetja do të sigurohet nga:

1.3 Menaxhimi i Cilësisë

Objektivi

Të menaxhojë cilësinë e veprimtarisë institucionale dhe të auditimit në mënyrë që obligimet e cilësisë të Zyrës së Auditimit nën standardet e INTOSAI-it janë përbushur.

Çfarë do të bëjmë

1. Ne do të zhvillojmë një udhëzues të hollësishëm të Menaxhimit të Cilësisë të Auditimit për të vendosur të priturat dhe metodat të cilat duhet plotësuar kërkesat e një standardi ndërkombëtar;
2. Ne do të funksionalizojmë procesin e Menaxhimit të Cilësisë, përmes trajnimeve, këshillave dhe mbështetjeve të vazhdueshme për të siguruar synimin dhe realizimin e procedurave dhe ndikimin e tyre individual që përgjegjësitë të jenë kuptuar plotësisht nga të gjithë anëtarët e Zyrës së Auditimit, dhe që të njëjtat janë realizuar si duhet.

REZULTATI

Një Udhëzues i Menaxhimit të Cilësisë të Auditimit në gjuhën Shqipe dhe atë Serbe.

Treguesit e Performancës

1. Menaxhimi i Burimeve Njerëzore, Menaxhimi i rrezikut, Planifikimi, Kontrolli i Brendshëm, Mësimi dhe Marrdhëniet e Jashtme të Zyrës së Auditimit në përputhje me standardet e Cilësisë;
2. Kontrolli i Cilësisë vepron në të gjitha fazat e Ciklit të Auditimit, dhe kontrollohet përmes mbikqyrjes së vazhdueshme;
3. Mbikqyrja e Cilësisë vepron në të gjitha fazat e Ciklit të Auditimit, dhe kontrollohet përmes shqyrtimeve të kohë pas kohëshme të dosjeve të Planifikimit dhe Auditimit;
4. Garantimi i aktiviteteve të Cilësisë së Jashtme vepron dhe përcakton që standardet e praktikave të vendosura nga Njësia e (Ardhshme) e Metodologjisë janë përmbushur.

Përgjegjësia i delegohet:

Udhëheqesi i Njesisë së Metodologjisë

Mbështetja do të sigurohet nga:

Projekti i Binjakëzimit

1.4 Zhvillimi Strategjik

Objektivi

Identifikimi i veprimeve të ndërlidhura me planifikimin e palëve përgjegjëse përkitazi me resurset dhe kohën, që japin udhëzime të përgjithshme në arritjen e objektivave të Auditorit të Përgjithshëm.

Çfarë do të bëjmë

Ne do të përgatisim një Plan Strategjik Zhvillimor (PSZH) që përcakton objektivat strategjike të Zyrës së Auditimit, shqyrton statusin aktual të Zyrës së Auditimit dhe rrethanat në të cilat ajo operon, identifikon mundësitë për të arritur objektivat dhe i ndërlidhë këto me veprime konkrete.

REZULTATI

Një Plan Strategjik i Zhvillimit i vënë në dispozicion për stafin (ashtu siç është përcaktuar nga Auditori Përgjithshëm) në gjuhën shqipe dhe atë serbe.

Treguesit e performancës

1. Të gjithë akterët e identifikuar në PSZH i kuptojnë dhe i pranojnë përgjegjësitë për veprimet e identifikuara.
2. Objektivat organizative janë harmonizuar me objektivat personale dhe mandatet e njësive funksionale të Zyrës së Auditimit.
3. PSZH-ja është shqyrtuar së paku çdo vit dhe u integrua në procesin e RVP-në.

Kush është përgjegjës

Auditori i Përgjithshëm

1.5 Udhëzuesi i Auditimit të Rregullsisë

Objektivi

Për të siguruar se Auditimi përmbush standardet e INTOSAI-it.

Çfarë do të bëjmë

- Ne do të angazhohemi në procesin që është në vazhdim e sipër në përpilimin e Udhëzuesit të Auditimit të Rregullsisë që ndërton komponentët individuale që aktualisht ekzistojnë, që paraqet praktikat më të mira të procesit të auditimit dhe që përmbush standardet ndërkombëtare (në mënyrë specifike ISSAI-të të propozuar);
- Ne do të zhvillojmë dhe adaptojmë mjete mbështetëse siç janë modele të dokumenteve të punës, teknika ndihmëse të auditimit me kompjuter etj.
- Ne do të inkorporojmë të kuptuarit e hollësishëm të UAR-it në programet e trajnimit në të ardhmen;
- Ne do të përfshijmë njohurinë për UAR-in në proceset e MBNj-së për sa i përket vlerësimit, emërimeve dhe avancimeve të stafit dhe veprimet tjera të plotësimit me kuadro.

REZULTATI

Udhëzuesi i Rregullsisë së Auditimit në dispozicion të stafit të auditimit në gjuhën shqipe dhe atë serbe.

Treguesit e performancës

1. Të gjithë anëtarët e ekipit të auditimit e kanë kuptuar përmbajtjen e UAR-it dhe përgjegjësitë e tyre për ekzekutimin e proceseve të identifikuara.
2. Ekzistoj procedurat për monitorimin e ndryshimeve në standardet ndërkombëtare dhe për implementimin e vazhdueshëm të përmirësimeve në UAR bazuar në standardet dhe kontributin nga anëtarët e ekipit të auditimit.
3. Në programin e trajnimit të zyrës së Auditimit dhe në vlerësimet e MBNj-së është inkorporuar njohuria mbi UAR-in.
4. Zhvillimi i të gjitha aspekteve të rregullsisë së auditimeve përputhet me standardet ndërkombëtare dhe pritjeve të cilësisë.

Përgjegjësia i delegohet:

Udhëheqësit e Njesisë së Metodologjisë

Mbështetja do të sigurohet nga:

Projekti i binjakëzimit

1.6 Udhëzuesi i Auditimit të Performancës

Objektivi

Njoftimi i auditorëve në lidhje me konceptet dhe praktikat e Performancës së Auditimit.

Çfarë do të bëjmë

- Ne do të iniciojmë një proces që të zhvillojë në vazhdimësi një pako të udhëzimeve të bazuara në praktikat e përcaktuara ndërkombëtare
- Ne do të zhvillojmë ose adoptojmë mjetet mbështetëse siç janë modele të dokumenteve të punës, teknika ndihmëse të auditimit me kompjuter etj.
- Ne do të caktojmë përgjegjësinë për mirëmbajtjen e doracakut nga një njësi organizative (Njësia e Metodologjisë) e cila do ta mbante atë të azhurnuar;
- Ne do të inkorporojmë të kuptuarit e hollësishëm të udhëzimeve në programet e ardhshme të trajnimit;
- Ne do të përfshijmë njohuritë e performancës së auditimit në proceset e ardhshme të MBNj-së sa i përket vlerësimit, emërimeve dhe avancimeve të stafit dhe veprimet tjera të plotësimit me kuadro.

REZULTATI

Udhëzuesi i Auditimit të Performancës të jetë në dispozicion të stafit të auditimit i caktuar për performancën e auditimit në gjuhën shqipe dhe atë serbe.

Treguesit e Performancës

1. anëtarët e ekipit të auditimit përgjegjës për kryerjen e auditimit të performancës e kanë kuptuar përmbajtjen e udhëzimeve dhe përgjegjësitë e tyre për ekzekutimin e proceseve të identifikuar.
2. njohuria e Udhëzimeve të Auditimit të Performancës është inkorporuar në programin e Trajnimit të Zyrës së Auditimit dhe në vlerësimet e MBNj-së.
3. udhëzimi mbi performancës e auditimit është aplikuar në administrimin e performancës së auditimeve.

Përgjegjësia i delegohet:

Udhëheqësit të Auditimit të Performancës

Mbështetja do të sigurohet nga:

Projekti i binjakëzimit

1.7 Kodi i Mirësjelljes

Objektivi

Nxitja e sjelljes profesionale ndërmjet anëtarëve të Zyrës së Auditimit që është në përputhje me standardet e shërbimit civil të Kosovës dhe inkorporon standardet e sjelljes etike të INTOSAI-it.

Çfarë do të bëjmë

- Ne do të ndryshojmë Kodin ekzistues të Mirësjelljes për të reflektuar të gjitha standardet relevante.
- Ne do të publikojmë Kodin e ndryshuar të Mirësjelljes në që të dy gjuhët zyrtare dhe do të familjarizojmë stafin e Zyrës së Auditimit me pritjet e përcaktuara përkitazi me sjelljet e tyre.
- Ne do të përfshijmë trajnime për Kodin e Mirësjelljes në procesin emërimeve të BNj-së për punonjësit e ri.
- Ne do të referojmë Kodin e Mirësjelljes në kontratat e punësimit dhe të kërkohet nga secili anëtar i stafit të ketë nënshkruar një kopje të Kodit (për ta përfshirë atë në dosjen e tyre të personelit); të vejnë në pah se ata i kanë kuptuar dhe janë të përkushtuar për standardet e mirësjelljes që kërkohen me këtë rast.
- Ne do të rifreskojmë periodikisht të kuptuarit e përgjegjësive nga ana e stafit, sipas Kodit, përmes politikës së komunikimit të brendshëm.
- Ne do të fuqizojmë pritjet sa i përket sjelljes dhe atë përmes këshillimit të vazhdueshëm dhe me shembullin e stafit menaxherial dhe ekzekutiv.
- Ne do të përfshijmë njohuri dhe përputhshmëri me Kodin në procesin e MBNj-së për sa i përket vlerësimit, emërimit, avancimit dhe veprime tjera të plotësimit me kuadro.

REZULTATI

Një Kod të Mirësjelljes i cili duhet të jetë në dispozicion të gjithë stafit të ZAP në Gjuhët Shqipe dhe atë Serbe.

Treguesit e performancës

1. Personeli e kupton Kodin dhe se si ai aplikohet në jetën e tyre.
2. Dosjet e personelit përmbajnë një kopje të nënshkruar të Kodit të Mirësjelljes.
3. Kontrata e punës i referohen Kodit.
4. Përputhshmëria me Kodin është e inkorporuar në procesin e MBNj-së për sa i përket vlerësimit, emërimeve dhe avancimeve të stafit dhe veprimet tjera të plotësimit me kuadro.
5. Stafi i Zyrës së Auditimit sillet në mënyrë profesionale.

Përgjegjësia i delegohet:

Burimeve Njerëzore

1.8 Struktura organizative

Objektivi

Organizimi i auditimit dhe funksioneve mbështetëse ashtu që Zyra e Auditimit të funksionojë në mënyrë efektive dhe efikase, dhe të ofron një mjedis evolutiv që nxit profesionalizmin.

Çfarë do të bëjmë

- Ne do të zhvillojmë strukturë të re organizative që promovon arritjen e objektivave të Zyrës së Auditimit, përgjegjësinë për rezultatet dhe komunikimin efikas dhe kjo reflekton aspiratën institucionale të kompletimit të Kosovarizimit.
- Ne do të përgatisim Doracakun Administrativ që reflekton organizimin dhe përgjegjësitë e komponentëve të saj.
- Ne do të zhvillojmë mandatet operacionale që definojnë përgjegjësitë dhe ndër-marrëdhëniet në mes të secilës njësi organizative.
- Ne do të familjarizojmë stafin nëpër të gjitha Zyrat e Auditimit me strukturë të re organizative dhe përgjegjësi duke përdorur komunikimet zyrtare dhe këshillimin e vazhdueshëm.

REZULTATI

Një strukturë e re organizative është dokumentuar dhe implementuar në gjuhën shqipe dhe atë serbe.

Treguesit e performancës

1. Përgjegjësitë dhe llogaridhëniet organizative janë të qarta, janë kuptuar nga i gjithë stafi dhe, në përgjithësi, përputhen me qëllimet e Zyrës së Auditimit.
2. Mbështesin funksionet dhe e kuptojnë përgjegjësinë e tyre për të përmbushur nevojat e klientëve të brendshëm,
3. Është krijuar Njësia e Metodologjisë që zhvillon dhe mirëmban doracakët e udhëzimit praktik/procedurave dhe mbikëqyrë procesin e Menaxhimit të cilësisë.
4. Departamentet e Auditimit janë të organizuara që të reflektojnë gamë të ndryshme të aftësive që kërkohen për lloje të ndryshme të auditimit/entitet auditimi, veçanërisht duke përfshirë ndarjen e performancës së auditimeve nga auditimi financiar dhe ai i rregullsisë, dhe auditimet e ndërmarrjeve të bazuara në para te gatshme nga ato që bëjnë llogaritje në baza akruale.
5. Bashkëpunimi dhe koordinimi ndërmjet stafit të linjës dhe menaxhmentit e ekzekutivit është përmirësuar dhe mundësia e bllokimit të informatave është mënjanuar.
6. Është përcaktuar një funksion i auditimit të brendshëm.

Përgjegjësia i delegohet:

Burimeve Njerëzore

1.9 Komunikimi i brendshëm

Objektivi

Komunikimi me kohë i informatave teknike dhe korporative që përmirësojnë profesionalizmin dhe inkurajojnë të mësuarit e përbashkët, pozitiv kulturor në Zyrën e Auditimit.

Çfarë do të bëjmë

- Ne do të zhvillojmë politikën e komunikimit duke parashtruar objektivat, metodat, veprimet dhe masat e performancës;
- Ne do të caktojmë përgjegjësinë për implementimin, përcjelljen dhe rishikimin e ndikimit të politikës tek individët përgjegjës.
- Ne do të sigurojmë që secili anëtarë i stafit të ketë kuptuar përgjegjësinë e tij për implementimin dhe zbatimin e politikës.

REZULTATI

Politika e Komunikimit në gjuhën shqipe dhe Serbe i udhëzon komunikimet e brendshme të Zyrës së Auditimit.

Treguesit e performancës

1. Personeli i Zyrës së Auditimit është i angazhuar në mënyrë aktive në gjurmimin e mundësive të mësimin.
2. Personeli i Zyrës së Auditimit shpreh kënaqësinë me kulturën organizative dhe mënyrën se si ajo është zbatuar përmes komunikimeve të qarta.
3. Është një ndjenjë e përbashkët e pikësynimit në mesin e personelit të Zyrës së Auditimit.

Përgjegjësia i delegohet:

Funksionit të komunikimeve

Mbështetja do të sigurohet nga

Projekti i binjakëzimit

1.10 Mbështetja efektive e TKI-së

Objektivi

Ofrimi i mbështetjes optimale na ana e TKI-së për Zyrën e Auditimit që i përgjigjet nevojave të klientëve të saj të brendshëm, veçanërisht duke përfshirë:

- besueshmërisë së pajisjes dhe qasjes në resurset e rrjetit;
- minimizimit të cenimeve potenciale të sigurisë;
- minimizimit të riskut dhe ndikimi i problemeve për sa i përket sigurisë, ruajtjes së të dhënave, pajisjes së TKI-së dhe aftësive teknike;
- gjurmimin e mundësive për përdorimin e TKI-së në operacionet e auditimit.

Çfarë do të bëjmë

- Ne do të rifreskojmë Strategjinë aktuale të TKI-së;
- Në bashkëpunim me departamentet tjera të Zyrës së Auditimit ne do të Përcaktojmë se çka kërkohet nga resurset e TKI-së për të harmonizuar kontributet e tyre në qëllimet e Zyrës së Auditimit;
- Ne do të bëjmë priorizimin e objektivave dhe sigurojmë resurset e nevojshme;
- Ne do të përcaktojmë përgjegjësitë në arritjen e objektivave për një individ përgjegjës;
- Ne do të ndjekim burimin e pavarur të mjeteve të jashtme të rrjetit (Internetin);
- Ne do të zhvillojmë dhe zbatojmë politikat për menaxhimin e riskut dhe restaurimin e kolapsit të vazhdimësisë së biznesit;
- Ne do të përfshijmë kërkesat e personelit të TKI-së për trajnim në planin e trajnimit korporativ;
- Ne do të përfshijmë aftësitë teknike të TKI-së për auditorët dhe stafin mbështetës në planin e trajnimit korporativ;
- Ne do të identifikojmë mundësitë për personelin e TKI-së që të kontribuojë në zhvillimin e Zyrës së Auditimit duke ofruar trajnim të brendshëm të TKI-së për stafin tjetër.

REZULTATI

Platforma optimale e TKI-së, e përkushtuar për qasje në internet, menaxhimin të riskut dhe planeve të restaurimit të kolapsit të vazhdimësisë së biznesit, planet e trajnimit për stafin e TKI-së si dhe stafin e auditimit dhe atë mbështetës dhe resurset e trajnimit të brendshëm të TKI-së.

Treguesit e performancës

1. Progresi me kohë në drejtim të objektivave strategjike;
2. Përdoruesit e TKI-së së Zyrës së Auditimit të kënaqur me mjetet dhe mbështetjen e ofruar;
3. Të gjithë akterët në menaxhimin e riskut dhe planeve të restaurimit të kolapsit të kontinuitetit të biznesit i kuptojnë rolet e tyre;
4. Përmbytja e TKI-së është paraqitur plotësisht në planin e trajnimit korporativ;
5. Stafit i TKI-së është i trajnuar ka aftësi të duhur;
6. Trajnimi brendshëm i TKI-së është në dispozicion për stafin në të gjitha Zyrat e Auditimit;
7. Kontratat e punës për stafin e TKI-së dhe diagrami për Njësinë e TI-së reflekton rolin dhe përgjegjësitë e tyre në përmbushjen e objektivave dhe fuqizimin e përgjegjësisë së tyre në shërbimin e klientëve të brendshëm.

Përgjegjësia i delegohet:

Udhëheqësit të Njësisë së TI-së

Mbështetja do të sigurohet nga:

Projekti i binjakëzimit

1.11 Menaxhimi i Përmirësuar Financiar

Objektivi

Të menaxhohet në mënyrë pro-aktive përdorimi i burimeve të buxhetit për të harmonizuar performancën vepruese dhe zhvillimin institucional të Zyrës së Auditimit në pajtim me pritjet bashkëkohore.

Çfarë do të bëjmë

- Ne do të implementojmë një sistem të menaxhimit të buxhetit, ose të administruar lokalisht ose bazuar në qasje lokale në sistemin e centralizuar të Thesarit (duke presupozuar se sistemi i Thesarit është i azhurnuar).
- Ne do të implementojmë një proces për azhurnimin e rregullt të sistemit të menaxhimit të buxhetit dhe raportimit me kohë tek ekzekutivi i Zyrës për veprim adekuat.
- Ne do të kryejmë kontrolle adekuate të kontrolleve të brendshme mbi pagesat.
- Ne do të zbatojmë sistemin e Menaxhimit të Aseteve.
- Ne do të zbatojmë sistemin TKI të Menaxhimit të Aseteve.
- Ne do të zbatojmë një sistem të automatizuar të kohës dhe të vijueshmërisë.
- Ne do zbatojmë një proces për përcjelljen e performancës së Zyrës së Auditimit kundrejt treguesve strategjik.
- Ne do të involvojmë Njësinë e Buxhetit dhe Financave në këshillimin e menaxhmentit përkitazi me përmirësimet e mundshme operacionale.

REZULTATI

Një koleksion të integruar të sistemeve, proceseve dhe kontrolleve të brendshme që do t'i mundësojnë Njësisë së Buxhetit dhe Njësisë Financiare që plotësisht të kontribuojnë objektivit të Zyrës së Auditimit për të qenë profesional dhe institucion i prirur në performancë.

Treguesit e performancës

1. Raportet mujore të ekzekutimit të buxhetit që tregojnë qartë, kundrejt secilës vijë të buxhetit, sa është buxheti, sa është shpenzuar, sa është aktualisht i zotuar por që nuk është shpenzuar dhe bilanci i fondeve të pazotuara dhe të pa shpenzuara.
2. Raportet mujore menaxheriale që tregojnë gjendjen financiare aktuale dhe të planifikuar të Zyrës dhe të secilës nga njësitë e saj organizative dhe rekomandimi i veprimeve adekuate.
3. Raportet mujore menaxheriale krahasojnë performancën aktuale kundrejt treguesve të performancës strategjike dhe rekomandimi i veprimeve adekuate optimale.
4. Informata gjithëpërfshirëse, aktuale dhe të dobishme përkitazi me kohën dhe vijueshmërinë e të gjithë anëtarëve të stafit të ofruar me kohë për menaxhmentin.
5. Auditime të brendshme dhe të jashtme konstatuan kontrollet e brendshme mbi funksionet financiare të Zyrave dhe resurseve të pranueshme.
6. Informata gjithëpërfshirëse të azhurnuara përkitazi me asetet përfshirë asetet e TKI-së, të siguruara, të cilët janë përdorur dhe larguar nga përdorimi, janë në dispozicion po qe se kërkohen.

Përgjegjësia i delegohet:

Drejtori i Administratës

Mbështetja do të sigurohet nga:

Projekti i binjakëzimit

1.12 MBNj e përmirësuar

Objektivi

Krijimi i kulturës të prirë për performancë në të cilën Zyra e Auditimit i përmbush objektivat e saja operacionale dhe zhvillimore përmes punëtorëve profesional, etik dhe të motivuar në të gjitha nivelet

Çfarë do të bëjmë

Ne do të krijojmë dhe zbatojmë politika dhe praktika gjithëpërfshirëse, bashkëkohore dhe transparente të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore (MBNj) që e adresojnë:

- definimin e punës;
- rekrutimin;
- përzgjedhjen;
- orientimin;
- trajnimin dhe zhvillimin (përgatitja e planeve individuale të zhvillimit për t'i ndihmuar secilit anëtar të stafit që të përmbush pritjet e publikuara si për postin e tyre aktual dhe, aty ku është e përshtatshme, për avancim të mundshëm);
- arsimimin;
- vlerësimin (zhvillimi i një metode të vlerësimit që krahason arritjet akademike, aftësitë, përvojën dhe performancën e titullarit për secilën pozitë së bashku me pritjet e parashtruara për të shkuar para);
- këshillimin;
- stimulimet;
- kompensimet;
- mbarimin;
- veprime tjera të personelit (marrja në konsideratë e ri-caktimeve të individëve për të bërë përdorimin më të mirë të kapaciteteve ekzistuese).

REZULTATI

Një koleksion i integruar i politikave të MBNj të mbështetura nga përshkrimi i qartë i punës dhe diagramet organizative, së bashku me programin gjithëpërfshirës të trajnimit, të gjitha në dispozicion në Gjuhën Shqipe dhe atë Serbe.

Treguesit e performancës

1. Ekzistojnë definicionet e hollësishme për të gjitha punët dhe diagramet për të gjitha njësitë organizative që përshkruajnë me përgjegjësi caqet e performancës dhe kriteret e vlerësimit;
2. Morali i stafit është i lartë;
3. Menaxherët dhe Drejtorët marrin përgjegjësi;
4. Objektivat dhe shpërblimet e personelit janë në përputhshmëri me qëllimet e zyrës së auditimit;
5. Personeli në të gjitha nivelet i nënshtrohet vlerësimit të rregullt kundrejt standardeve të përcaktuara për secilën pozitë;
6. Rekrutimi dhe avancimi janë transparent dhe i bazuar në kriteret objektive të publikuara mbi arritjet akademike, aftësitë, eksperiencën dhe performancën;
7. Stafit në të gjitha nivelet ka aftësi që të përmbush përshkrimet e tyre të punës;
8. Një program gjithëpërfshirës i Trajnimit, që bazohet në vlerësimet e nevojave të trajnimit, parashtron veprimet e përbashkëta dhe individuale të trajnimit që duhen të ndërmerren.

Përgjegjësia i delegohet:

Drejtorit të MBNj-së

Mbështetja do të sigurohet nga:

Projekti i binjakëzimit

1.13 Udhëheqja

Objektivi

Krijimi i performancës së lartë, Zyra profesionale e Auditimit.

Çfarë do të bëjmë

Ne do të iniciojmë dhe promovojmë një kulturë të re të mësimin, duke zhvilluar aftësitë teknike dhe të lehta si dhe sjellje profesionale në gjithë stafin të cilët mbajnë pozita menaxheriale dhe mbikëqyrëse. Kjo do të arrihet përmes programit të këshillimit nga lartë poshtë me të cilin Auditori i Përgjithshëm (i mbështetur nga resurset e jashtme ashtu si vihen në dispozicion) do të ofrojë këshillim në praktik, në kontestin e aktiviteteve operacionale dhe mbledhjeve të përditshme të planifikuara, për stafin ekzekutiv dhe menaxherial.

Me zhvillimin e kapaciteteve, këshillimi gjithnjë e më shumë do të delegohet nga Zëvendësi i Auditorit Gjeneral, stafi menaxherial dhe zyrtarë të lartë të auditimit, derisa secili nivel në të gjitha Zyrat e Auditimit angazhohet në këshillimin konstant të niveleve më poshtë. Të gjithë menaxherët dhe mbikëqyrësit do të kontribuojnë që në mënyrë konstante të udhëheqin dhe të jenë shembull.

Treguesit e performancës

1. Stafit është i sigurtë se ata e kanë kuptuar se si të përmbushin përgjegjësitë e tyre;
2. Stafit është i kënaqur me nivelin e këshillimit që e ka marr;
3. Stafit sillet në pajtim me qëndrimin e prirur për performancë, përgjegjësi dhe të bazuar në ekip.

Përgjegjësia:

Auditori Gjeneral dhe të gjithë menaxherët dhe mbikëqyrësit.

1.14 Udhëzuesi Strategjik i Auditimit

Objektivi

Të ofrojë udhëzime strategjike në përputhjen e planifikimeve të auditimit dhe vendimeve të realizimit, në lidhje me rrezikun e bazuar të alokimit të burimeve të auditimit.

Çfarë do të bëjmë

Kryesuesi i Zyrës së Auditimit do të zhvillojë një plan që trajton se si Zyra e Auditimit interpreton obligimet e veta sipas ligjit në kuptimin e mbulimit të auditimit, dhe si ai interpretim mundet të zbatohet përmes alokimit të burimeve të bazuara në rrezik.

Për të bërë dallimin nga situata e tanishme, Plani Strategjik i Auditimit do të lejojë mundësinë e:

- Auditimeve të pjesërishme;
- Auditimeve të përkohshme;
- Auditime që nuk qojnë në opinionet e pasqyrave financiare;
- Auditime ndër-qeveritare të funksionalitetit/sistemeve;
- Mbështetja në kontrollet e brendshme;
- Dhe shtrirja e auditimit mbi ciklet shumë-vjeqare (se sa vjetor)

... Për t'i dhënë më shumë hapësirë për alokim të efektshëm të burimeve auditimit në origjinen e rrezikut.

REZULTATI

Një seri udhëzimesh të thjeshta të cilat shpiejnë në vitin 3 të formimit të Planit Strategjik të Auditimit në Gjuhen Shqipe dhe Serbe, të cilat do të udhëzojnë zhvillimin e Planeve Vjetore.

Treguesit e Performancës

1. Planet Vjetore të Auditimit kanë lidhshmëri me Planin Strategjik të Auditimit të vitit aktual.
2. Auditimet planifikohen bazuar në vlerësimet formale të rrezikut.

Përgjegjësia:

Auditori i Përgjithshëm dhe grupi menaxhmentit

Mbështetja do të sigurohet nga:

Projekti i Binjakëzimit

1.15 Objekte të përshtatshme

Objektivi

Të zgjedh objektet fizike të Zyrës së Auditimit në lidhje me përmasat, vendndodhjen, përshtatjes për qëllim, koston, sigurisë dhe stabilitetit afatgjatë.

Çfarë do të bëjmë

- Çartësojmë kërkesat e Zyrës së Auditimit me qëllim të rregullimit të rritjes së parashikuar dhe ndryshimeve organizative;
- Kërkojmë rrugët në adresimin e kërkesave, në lidhje me kontraktimin dhe financimin;
- Hulumtojmë mundësitë;
- Sigurojmë objekt të përshtatshëm.

Treguesit e Performancës

1. Janë siguruar objekte optimale
2. Personeli tregon knaqësi me kushtet e punës.

Përgjegjësia i është deleguar:

Drejtorit të Administratës

1.16 Rishikimet e përbashkëta

Objektivi

Të vlerësojë progresin e Zyrës së Auditimit kundrejt objektivave të saja të performancës.

Çfarë do të bëjmë

- Identifikojë organizatat homologe të cilat rishikojnë veprimtarinë e Zyrës së Auditimit.
- Angazhohen në rishikim të përbashkët.
- Veprojnë në rekomandime.

REZULTATI

Raporte objektive mbi performancën nga organet e jashtme të pavarura që përmbajnë rekomandime për përmirësime të veprimtarisë dhe që shpiejnë drejt veprimeve të duhura nga Zyra e Auditimit.

Treguesit e Performancës

1. Zyra e Auditimit shfaq përparimin e matshëm kundrejt objekteve të saja strategjike.

Përgjegjësia:

Auditori i Përgjithshëm

2.0 Manaxhimi i Marrëdhënieve

2.1 Shpërndarja në Kuvend, Komision për Buxhet dhe Financa

Objektivi

Të vendos marrdhënie të frytshme me hisedarët kryesor bazuar në një mirkuptim të ndërsjellë të rolit të njëri tjetrit.

Çfarë do bëjmë

Ne do të inicojmë bisedime të rregullta në mes të kontakteve të duhura në Kuvend dhe Komisionit të tij për Buxhet dhe Financa për të ngritur një marrdhënie efektive pune të bazuar në mirëkuptim të ndërsjellë të objektivave dhe në atë se si ta bëjmë marrdhenien më të dobishme.

REZULTATI

Nuk ka ndonjë rezultat të veçantë.

Treguesit e Performancës

1. Kuvendi dhe komisionet e saj të kuptojnë rolet e tyre dhe rolin e Auditorit të Përgjithshëm në kuadër të zinxhirit të përgjegjshmërisë;
2. Kuvendi dhe komisionet e saj janë të kënaqur me mënyrën se si bashkëveprojnë me Auditorin e Përgjithshëm;
3. Kuvendi dhe komisionet e saj janë të kënaqur me mënyrën se si Zyra e Auditimit dorëzon informata (përfshirë RVP-ne, RVA-ne, dhe raportet tjera të Auditimit, rekomandimet dhe opinionet);
4. Auditori i Përgjithshëm është i kënaqur me nivelin e dialogut të vazhdueshëm me Kuvendin dhe që burimet e Zyrës së Auditimit janë në përputhje me të priturat e vendosura nga Auditori i Përgjithshëm;
5. Auditori i Përgjithshëm është larguar nga fushat e ligjeve dhe rregulloreve të Shërbimit Civil.

Përgjegjësia:

Auditori i Përgjithshëm

3.0 Sinkronizimi me Partnerët

3.1 Zhvillimi i programeve mësimore me universitete

Objektivi

Të ndikojë në sektorin e lartë të edukimit që studentet të sigurohen me përgatitje adekuate për karrierë profesionale.

Çfarë do të bëjmë

Ne do të:

1. fillojmë bisedimet me Ministrinë e Arsimit dhe shkollat individuale për të lobuar në përfshirjen e kurseve analitike në kuadër të një shaklle të programeve që sigurojnë hyrje për profesione (sikur analizat e sistemeve, logjika, kontabiliteti, ligji, analizat kuantitative (statistika) matematika, gjuha Angleze dhe shkrimi afarist);
2. identifikojmë dhe punojmë me palët tjera të interesuara, siç janë shkollat, organizatat profesionale, qeveritë, donatorët, punonjësit e sektorit privat, për t'i drejtuar objektivat, koordinuar burimet dhe përkrah diplomimin e studentëve të cilët kanë baze të mirë për trajnime profesionale.
3. vendosim një rrjet të palëve të interesuara në përkrahje të profesionalizmit.

REZULTATI

Nuk ka ndonjë rezultat të veçantë.

Treguesit e Performancës

1. Të rekrutuarit e rinj janë të përgatitur më mirë që të fillojnë me trajnime profesionale.

Përgjegjësia i është deleguar:

Zëvendës Auditorit të Përgjithshëm

3.2 Donatorët

Objektivi

Të harmonizojë dhe koordinojë mbështetjen e çmuar e siguruar nga donatorët që të ngrisë ndikimin e saj në Zyrën e Auditimit.

Çfarë do të bëjmë

Ne do të:

- Zhvillojmë orare të llojeve dhe alokimeve të mbështetjes e cila do të jetë më e frytshme për të hecur përpara;
- Ne do të komunikojmë fokuset e preferuara dhe modalitetet teknike të së ardhmes dhe ndihmesat tjera tek donatorët që të jenë si inpute në planifikimin e tyre.

REZULTATI

Një orar i aktiviteteve të asistencës teknike nga e cila Auditori i Përgjithshëm do dëshirojë të përfitojë nga ajo.

Treguesit e Performancës

1. Mbështetja është e programuar në atë mënyrë që pasqyron prioritetet e Zyrës së Auditimit dhe mundësinë për t'i absorbuar ato.

Përgjegjësia:

Auditori i Përgjithshëm

3.3 Njësitë e Auditimit të Brendshëm dhe NJQH/AB

Objektivi

Të përputh përpjekjet e përbashkëta të auditimit të kuadrit të auditimit të brendshëm me Zyrën e Auditimit.

Çfarë do të bëjmë

- Kryesuesi i Zyrës së Auditimit do vendos komunikim të rregullt me Njësinë Qendrore të Harmonizimit për Auditim të Brendshëm në mënyrë që të vendosin se cilat janë mundësitë për punën e auditimit të brendshëm për të plotësuar punën e Zyrës së Auditimit që në atë mënyrë të zvogëlojë sasinë e përgjithshme të përpjekjeve dhe ndikimin i asaj pune tek entitetet e audituara.
- Drejtorët e Departamenteve do vendosin komunikim të rregullt me Udhëheqësit e Auditimit të Brendshëm në shumicën e entiteteve të audituara për të hulumtuar mundësitë e ligjshme në zvogëlimin e punës për Zyrën e Auditimit kjo në baxze të një vlerësimi të knaqëshëm të vlersimeve nga auditimi i brendshëm për kontrollet e brendshme.

REZULTATI

Nuk ka ndonjë rezultat të veçantë.

Treguesit e Performancës

1. Auditimet e Zyrës së Auditimit nuk persërisin punën e kryer nga Njësitë e Auditimit të Brendshëm ku ajo punë është cilësuar të jetë e knaqshme;
2. Puna e kryer nga Njësia e Auditimit të Brendshëm është në dispozicion të dhe për përdorim nga ana e ekipeve audituese të Zyrës së Auditimit.

Përgjegjësia i është deleguar:

Auditori i Brendshëm/Zëvendës Auditori i Përgjithshëm/Drejtorët e Departamenteve të Auditimit

3.4 NJQH/KMF

Objektivi

Të përputh zhvillimin dhe zbatimin e kontrolleve të menaxhimit financiar nëpër Qeveri të Kosovës.

Çfarë do të bëjmë

- Kryesuai i Zyrës së Auditimit do të vendos një marrdhënië me Njësinë Qendrore të Harmonizimit për Kontrol të Menaxhimit Financiar që të vazhdojë me zhvillimin dhe zbatimin e kontrolleve të menaxhimit financiar.

REZULTATI

Nuk ka ndonjë rezultat të veçantë.

Treguesit e Performancës

1. Përmirësim i vazhdueshëm i mjedisit të kontrollit përkrahur nga NJQH/KMF;
2. Përmirësim i vazhdueshëm në zbatimin e kontrolleve nga entitetet e auditimit.

Përgjegjësia i është deleguar:

Zëvendës Auditori i Përgjithshëm

3.5 Ministria për Ekonomi dhe Financa

Objektivi

Të vendos një marrdhënie pune të shëndoshë dhe profesionale me entitetin kryesor të auditimit të Zyrës së Auditimit.

Çfarë do të bëjmë

- Koordinimi i aktiviteteve që ndërlidhen me aktivitetet e përkohshme të auditimit, krijimi i pasqyrave financiare, testimi i kontrolleve, planifikimi dhe realizimi i auditimeve, diskutimi i rekomandimeve etj.

REZULTATI

Nuk ka ndonjë rezultat të veçantë.

Treguesit e Performancës

1. Marrdhënië bashkëpunuese pune
2. Mirëkuptimi i të i mjedisit veprues të MEF-it, planeve dhe çështjeve
3. Alokim i harmonizuar dhe caktim të burimeve të auditimit
4. Përmirësim i vazhdueshëm në kualitetin e pasqyrave financiare të MEF-it dhe në vlerë të procesit të auditimit dhe raportimit.

Përgjegjësia i është deleguar:

Zëvendës Auditori i Përgjithshëm

3.6 Trajnimi dhe Certifikimi i Organeve

Objektivi

Të harmonizojë kontributin e partnerëve të trajnimit dhe certifikimit në përmbushjen e nevojave zhvillimore profesionale të Zyrës së Auditimit.

Çfarë do të bëjmë

Ne do të:

- Identifikojmë partnerët e trajnimit dhe certifikimit me të cilët marrdhënia do të kishte vlera (e.g. SCAAK, ACCA, CIPFA, CEF);
- Përcaktimi i objektivave të Zyrës së Auditimit në lidhje me trajnimin, certifikimin dhe edukimin e vazhdueshëm profesional;
- Vendosja e komunikimit me furnizuesit potencial dhe bisedimi i kushteve më të përshtatshme në harmoni me programet e tyre;
- Integrimi i programeve të furnizuesve me programet e trajnimit dhe zhvillimit të karrierës të Zyrës së Auditimit.

REZULTATI

Nuk ka ndonjë rezultat të veçantë.

Treguesit e Performancës

1. Marrëveshje Mirëkuptimi me partnerët e zgjedhur të trajnimit dhe certifikimit;
2. Pikësynimet e vendosura dhe të arritura për progres të auditorëve përmes programeve të zgjedhura.

Përgjegjësia i është deleguar:

Drejtorit të MBNJ-së

3.7 Kompanitë e Auditimit

Objektivat

Të zhvillojmë marrëdhënie efektive komerciale me kompanitë të cilat Zyra e Auditimit do të bartë punën e vet, apo tek ata të ciët Zyra e Auditimit do të mund të nën-kontrakttojë shkathtësi të veçanta.

Çfarë do të bëjmë

Ne do të:

- Zhvillojmë kritere për identifikimin e kompanive të cilat janë partnerë të besueshëm;
- Zhvillojmë dhe zbatojmë një proces për të identifikuar kompanië me të cilat ne mund të punojmë, krijimi i një liste për selektim në të ardhmen;
- Krijojmë një autojmet të përshtatshëm kontraktues në mënyrë që puna e auditimit është bartur jashtë në mënyrë konkurruese por me burokraci minimale e të të panevojshme e cila mund të shton kosto dhe vonesa (vonesa të tilla mund të para-negociohen, apo me qasje të ngushtimit të listës);
- Komunikojmë bartjet jashtë të Zyrës së Auditimit dhe përpjekjet e nën-kontraktimit me kompanitë e auditimit në mënyrë që të standardizojë nivelin e interesit dhe të përkrah koordinimin e furnizimit në bazë të nevojave;
- Zbatojmë proceset tenderuese në mënyrë konkurruese por edhe të efektshme.

REZULTATI

Mekanizëm i përvijuar për kontraktim, lista e firmave të auditimit të paraaprovuara, raportet e auditimit të prodhuara me kohë dhe me kualitet të pranueshëm.

Kriteret e performancës

1. Ekziston lista e firmave të aprovuara;
2. Mjeti i përvijuar kontraktues është në vend;
3. Nevojat e Zyrës së Auditimit për kontraktim të jashtëm ose nënkontraktim përmbushen me çmime ekonomike dhe me kohë.

Përgjegjësia i delegohet:

Zëvendës Auditorit të Përgjithshëm

3.8 Mediat

Objektivat

Zhvillimi i marrëdhënieve efektive me mediat në mënyrë që aktivitetet e Zyrës së Auditimit të prezantohen drejtë dhe në mënyrë objektive.

Çfarë do të bëjmë

Ne do të:

- Zhvillojmë synimet për marrëdhënien tonë me media;
- Krijojmë pika kontakti në agjenci të lajmeve dhe të ndërtojmë marrëdhënie të besueshme;
- Përgatitjen e komunikatave për shtyp për aktivitetet ose të arriturat e vlefshme të Zyrës së Auditimit;
- Jemi proaktiv në menaxhimin e informatave që publikohen në domenin publik në lidhje me Zyrën e Auditimit dhe aktivitetet e saj me qëllim të identifikimit të firmave që janë partnere të besueshme;

REZULTATI

Rrjedhë e menaxhuar e informatave në media.

Kriteret e performancës

1. Mbulimi nga media është objektiv dhe baraspeshuar.
2. Nurmi i komunikatave për shtyp.
3. Shtrirja e mbulimit të mediave.
4. Përceptimi i Zyrës së Auditimit nga publiku i krijuar përmes mediave.

Përgjegjësia i delegohet:

Funksionit të komunikimit

3.9 Komuniteti ndërkombëtar i ISA-ve

Objektivat

Pjesëmarrja në forumet e larta ndërkombëtare (posaçërisht INTOSAI dhe EUROSAI) në mënyrë që të përfitojmë nga praktikat ndërkombëtare dhe të kontribuojmë në zhvillimin e komunitetit rajonal të ISA-ve.

Çfarë do të bëjmë

Ne do të:

- Zhvillojmë synimet për marrëdhënien tonë me komunitetin e ISA-ve;
- Ndjekim mjetet për pjesëmarrje që nuk varen nga statusi jonë kombëtar;
- Marrim pjesë në mënyrë aktive në mundësitë për trajnim dhe konferenca;
- Kërkojmë mundësi për të kontribuar në zhvillimin rajonal të ISA-ve përmes pjesëmarrjes në komisione, kontribuimit me artikuj profesional dhe mjete tjera;
- Raportimi të stafi i Zyrës së Auditimit në mbledhje pune ose seansa joformale trajnimi për shpërndarjen e informatave të marra në forumet ku kanë marrë pjesë përfaqësuesit e Zyrës së Auditimit;
- Integrojmë pjesëmarrjen në komunitetin e ISA-ve me trajnime individuale dhe plane zhvillimore

REZULTATI

Nuk ka rezultate specifike

Kriteret e performancës

1. Artikujt e dorëzuar dhe të pranuar
2. Orët e pjesëmarrjes në aktivitetet zhvillimore të ISA
3. Njohja e kontributit tonë nga ISA-të
4. Koha e takimeve informuese që i ofrohet stafit të Zyrës së Auditimit

Përgjegjësia:

Auditori i Përgjithshëm

4.0 Komunikimi

4.1 Komunikimi i jashtëm

Objektivi

Promovimi i kuptimit të objektivave, operacioneve dhe rezultateve të aktiviteteve të Zyrës së Auditimit nga hisedarët.

Çfarë do të bëjmë

- Identifikimi i hisedarëve dhe përfaqësuesve të tyre;
- Caktimin e porosive që Zyra e Auditimit dëshiron t'i komunikoj dhe inputet që dëshiron t'i ketë;
- Zhvillimi dhe implementimi i strategjisë për angazhimin e komunikimeve të nevojshme, caktimin e objektivave, metodave dhe masave të performancës;
- Caktimi i përgjegjesisë një individi llogaridhënës për implementimin e politikës;
- Sondazh i hisedarëve për ndikimin e kësaj.

REZULTATI

Strategjia e komunikimit, materiale profesionale dhe me kualitet të lartë të publikuara (faqe zyrtare, broshura informative, transkripte të fjalimeve dhe prezantimeve, etj).

Treguesit e performancës

1. hisedarët kuptojnë rolin e Zyrës së Auditimit në qeverisjen publike;
2. Zyra e Auditimit kupton nevojat dhe pritjet e hisedarëve;
3. Numri i pikave të kontaktimit me hisedarët dhe partnerët;
4. Numri i konferencave vendore ku ka prezantuar Zyra e Auditimit;
5. publikimi i informatave gjithëpërfshirëse, të lehta për t'u kuptuar, të sakta dhe me kohë në lidhje me Zyrën e Auditimit përmes medimeve siç janë uebfaqja, broshurat informative, ngjarjet për rritjen e vetëdijësisimit.

Përgjegjësia i delegohet:

Funksionit të komunikimit

5.0 Mashtrimi dhe korrupsioni

5.1 Arritja te prokurori publik

Objektivi

Ndërtimi i një marrëdhënie efektive të punës me prokurorët publik në mënyrë që dëshmitë e mashtrimeve të raportohen në mënyrë të shpejtë për veprime nga autoritetet përkatëse.

Çfarë do të bëjmë

Ne do të:

- sigurojmë që operacionet tona të jenë të lira nga mashtrimet dhe korrupsionit, përmes implementimit të plotë të Kodit të Mirësjelljes dhe kontrolleve të brendshme efektive.
- vendosim linja komunikimi të rregullt me OLAF dhe me prokurorin publik përmes ekzekutivit të Zyrës së Auditimit;
- krijojmë protokollin për raportimin dhe përcjelljen e dëshmieve të mashtrimit të zbuluara gjatë aktiviteteve të auditimit;
- implementojmë një proces për gjurmimin e mashtrimeve dhe aktiviteteve korruptive të raportuara te autoritetet;
- planifikojmë një shqyrtim të efektivitetit të proceseve gjyqësore në Kosovë në ndjekjen e suksesshme të rasteve të mashtrimit dhe korrupsionit.

REZULTATI

Raportet e auditimit të brendshëm, protokollin për raportimin e mashtrimeve dhe aktiviteteve korruptive, raportet e brendshme të cilat gjurmojnë raportimet tona të mashtrimeve dhe korrupsionit dhe veprimet e ndërmarra nga prokuroria publike.

Treguesit e performancës

1. ekziston protokollin dhe i njëjti implementohet
2. ekzistojnë gjasat për zbulimin e mashtrimeve dhe aktiviteteve korruptive dhe të njëjtat i raportohen autoriteteve përkatëse;
3. prokurori publik është i kënaqur me marrëdhënien që kanë me Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën e Auditimit.

Përgjegjësia i delegohet:

Zëvendës Auditorit të Përgjithshëm

6.0 Çështjet Ligjore

6.1 Kornizë ligjore e ndryshuar

Objektivi

Të kemi një kornizë ligjore të harmonizuar e cila në mënyrë konsistente cakton rolin dhe kompetencat e Auditorit Gjeneral.

Çfarë do të bëjmë

Ne do të:

- rishqyrtojmë legjislacionin i cili ka ndikim në llogaridhënien dhe autoritetin e Auditorit Gjeneral dhe operacionet e brendshme dhe të jashtme të Zyrës së Auditimit;

- rekomandojmë amendamente të cilat janë të nevojshme për qartësimin dhe harmonizimin e dispozitave;
- promovojmë në mënyrë aktive miratimin e amendamenteve të rekomanduara.

REZULTATI

Një kornizë ligjore e ndryshuar e cila qartëson dhe ngurtëson rolin dhe autoritetin e Auditorit të Përgjithshëm.

Treguesit e performancës

1. ligjet janë të qarta dhe konsistente
2. Auditori i Përgjithshëm është i kënaqur me ndikimin e kombinuar të kornizës ligjore.

Përgjegjësia i delegohet:

Këshilltarit ligjor